

Akt Themelimi

KONTRATË PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË, PERSONIT JURIDIK
“Diamant Logistics“ SH.P.K.

Sot me datë 28.01.2025 , ortaku themelues:

PERIKLI GOGA , atësia Vlash , me shtetësi Shqiptare, lindur dhe banues në Durres , i datëlindjes 20.06.1960, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin nr. 036034272 dhe nr. personal G00520332P .

Me vullnetin tim te lirë kam vendosur si më poshtë vijon :

- NENI 1 -

Të themeloj shoqerinë person juridik emërtuar “**Diamant Logistics**“ sh.p.k.

Vendqëndrimi i shoqërisë tregtare “**Diamant Logistics**” sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të jetë në: Durres, Xhafzotaj Autostrada Tirane-Durres, Rruga e Fllakes, Godine 3-Kateshe 150 Metra Nga Rruga Nacionale

Shoqëria mund të hapë seli ose filiale të tjera në territorin shqiptar ose jashtë tij.

- NENI 2 -

Shoqëria zhvillon aktivitetin e vet në perputhje me këtë kontratë, statutin bashkëlidhur dhe ligjet materiale të Republikës së Shqipërisë.

- NENI 3 -

1. Objekti i aktivitetit është Shoqëri spedicionere, shërbime të transportit tokësor dhe detar si me mjetet e veta ashtu edhe me mjetet e të tretëve, si brenda Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, konsulencë në fushën e transportit ndërkombëtar, shoqëria mund të blejë, të shesë dhe të marri pjesë në formën e aksioneve ose jo edhe në të tjera shoqëri italiane apo të huaja që kanë objekt të njëjtë veprimtarie ose të ngjashme me të, shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, financiare, tregtare, të lidhi kontrata të dyanshme aktivi dhe pasivi me Institutet e Kreditit të autorizuara nga ligji dhe me shoqëritë dhe firmat private, të japi garanci reale edhe për të tretët dhe gjithçka që është e nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë. Transport ndërkombëtar dhe kombëtar mallrash për vete dhe të tretë, agjensi doganore, agjensi transport pasagjerësh në rrugë tokësore, detare dhe ajrore, transport mallrash me mjete jashtë norme. Agjensi doganore Ortaku i vetëm ka të drejtë të përcaktojë modalitetet për zgjerimin apo zvogëlimin e fushës së aktivitetit të kryer. Veç sa më sipër, në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjeter që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare.

2. Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

3. Shoqëria zbaton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar, për ushtrimin e veprimtarisë të saj.

- NENI 4 -

Sipas ligjit shqiptar, shoqëria regjistrohet si person juridik dhe kryhen të gjitha formalitetet në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit .

Kohëzgjatja e shoqërisë fiksohet deri më 20 vjet dhe mundet të prishet para kohe ose të zgjatet një ose më shumë herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

- NENI 5 -

Kapitali themelor i shoqërisë është i barabartë me shumën 100.000,00 lekë (njëqind mijë lekë) dhe përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale 100.000,00 lekë, që përfaqëson **100%** të kuotave të kapitalit, e zotëruar nga ortaku i vetëm **Z. Perikli Goga**

- NENI 6 -

Pjesët e pjesëmarries në kapitalin shoqëror janë të papjestueshme. Ato nënshkruhen, depozitohen totalisht nga ortakët në bazë të pjesëmarries së secilit në kapital. Çdo pjesë ka të drejtën e një vote. Pjesët janë lirisht të transferueshme vetëm pasi të jetë marrë miratimi me shkrim i të gjithë ortakëve.

- NENI 7 -

Ortaku që dëshiron të shesë pjesët tij të tretëve, duhet të njoftojë më parë ortakët të cilët gjëzojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditësh nga marrja dijeni. Në rast se blerja bëhet nga të tretë, ortaku që shet duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë emrin e blerësit dhe kushtet e shitjes.

- NENI 8 -

Organet drejtuese të shoqërise janë:

- a)Asambleja e ortakëve.
- b)Administratorët.

Aktiviteti, mënyra e organizimit të drejtimit, emërimi ose shkarkimi i drejtuesve si dhe probleme të tjera të rëndësishme do të organizohen në bazë të statutit të shoqërisë që është pjesë përbërëse e kontratës dhe dokumenteve të tjera që do të aprovohen nga Asambleja e ortakëve.

- NENI 9 -

Asambleja e ortakëve emëron si administrator të shoqërisë nga data 28.01.2025 deri ne daten 28.01.2030 Z.Perikli Goga , atësia Vlash , me shtetësi Shqiptare, lindur dhe banues në Durres , i datëlindjes 20.06.1960, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin nr. 036034272 dhe nr. personal G00520332P .

Administratorët , për probleme të veçanta, mund të delegojnë persona të tjerë me prokurë të veçantë ose të përgjithshme.

- NENI 10 -

Aktiviteti finansiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbylljet me 31 Dhjetor të çdo viti. Me mbylljen e aktivitetit vjetor do të bëhet bilanci dhe llogaritë fitim/humbje. Fitimi i realizuar, pasi të zbriten rezervat ligjore, do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me vlerën e pjesëmarries së secilit në kapitalin social,në rast se ortakët nuk vendosin për krijimin e rezervave të tjera.

- NENI 11 -

Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo motivi sipas kritereve të përcaktuara në statut. Në rastin e prishjes së shoqërisë për çfarëdo motivi qoftë, emërimi dhe revokimi i likujdatorëve i takon Asamblesë së Ortakëve e cila përcakton edhe kompetencat e tyre.

- NENI 12 -

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në mirëkuptim ndërmjet tyre. Në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e tyre do të jetë gjykata.

- NENI 13 -

Ky akt themelimi u përpilua në tre (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe të gjitha tekstet kanë fuqi të barabartë, njëra depozitohet në zyrën e Qendrës Kombëtare te Biznesit.

Durrës, më 28.01.2025

ORTAKU I VETEM

PERIKLI GOGA

